



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 980/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Aziz Pacolli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar për Kuvend Komunal të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Aziz Pacolli, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Aziz Pacolli kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ne të cilën pretendohet se ka pasur shkelje brenda subjektit politik të AKR-së. Sipas parashtruesit të ankesës komisionarët e AKR-së kanë keqpërdorur votën e të tjerëve për interesa të tyre. Parashtruesi i ankesës potencon se gjatë numërimit në KKZ të Prishtinës nga numërimi i një pjese të kutive më kanë dalë 130 vota më pak se $\frac{1}{2}$ e kutive dhe kryesisht më mungojnë votat ku mendoj në kutit 02,03,04 të cilët fillojnë me O,P,Q,R. Dyshimet e paraqitura në ankesë që pretenduesi mendon se ju kanë vjedhur votat janë në shkollat “Asim Vokshi”, “Emin Duraku”, “Zenel Hajdini”, “Nazim Gafurri” dhe në të gjitha shkollat tjera të Prishtinës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: “Mund te apelothen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se i mungojnë votat në Vendvotimet në shkollat “Asim Vokshi”, “Emin Duraku”, “Zenel Hajdini”, PZAP-i i konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse dëshmitë e ofruara nuk janë dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar dhe nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 980/2013 më datën 02.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.